



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 1718 Prot.

Laç, me 02.04.2019

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Lac, sot me date 02.04.2019

Une, Mikeda Cenaj, me detyrë Përmbarues Gjyqësore pranë Zyres Përmbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale të çështjeve përmbarimore Nr.368 dhe 369 rregjistri themeltar të vitit 2019 bazuar në Urdherin e ekzekutimit nr.235 të datës 25.10.2018 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës,

KONSTATOVA:

Se në datë 20.02.2019 është depozituar pranë Zyres së Përmbarimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor penal) nr. (1009)139 datës 18.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës
- Debitor: Gjovalin Mark Saliu (Gjoka) i dtj. 30.01.1983 me banim në Fushe-Mamurras.
- Me objekt: Pagim gjore penale dhe shpenzime proceduriale + tarifat fikse përmbarimore.

Nga ana e zyre tone përmbarimore kanë filluar procedurat në baze të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbarimor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultoi se debitori Gjovalin Mark Saliu (Gjoka) i dtj. 30.01.1983 nuk merr dijeni nëpërmjet sherbimit postar dhe si rezultat i kesaj bazuar në nenin 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria Rr.Gj. Kukës për gjore penale dhe shpenzimet proceduriale prej 56000 leke dhe tarifat fikse përmbarimore në masën 6720 leke.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbarimor Gjyqësor", i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 02/04/2019 - 21/04/2019 të debitorit Gjovalin Mark Saliu (Gjoka) i dtj. 30.01.1983 me banim në Fushe-Mamurras .

2-Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kesaj zyre, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Njesisë Administrative Mamurras, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Gjovalin Mark Saliu (Gjoka) i dtj. 30.01.1983 me banim në Fushe-Mamurras .

4-Pala debitore Gjovalin Mark Saliu (Gjoka) i dtj. 30.01.1983 me banim në Fushe-Mamurras, duhet të paraqitet pranë Zyres Përmbarimore Kurbin me seli në Lgj nr.4, Lac në katin e parë në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t'ju venë në dispozicion aktet përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 02.04.2019.

**PERMBARUES GJYQËSOR
MIKEDA CENAJ**

